



Mjedisi në këndvështrimin hebre

Description

Normon Solomon

Fragment i shkëputur nga libri “Abraham’s Children”, t&t clark 2005.

Fjala ‘ekologji’, e derivuar nga termi grek oikos (‘shtëpi’), mund të interpretohet lehtësisht si “shkenca e kuptimit dhe përkujdesjes për shtëpinë tonë”. Ekziston vetëm një shtëpi, ne duhet ta ruajmë planetin tonë, ti përdorim së bashku dhe në mënyrë të paqshme burimet e tij, përndryshe do të shkatërrohemi. Cfarë kontributi mund të japë besimi religjioz në ruajtjen e mjedisit? Hebrenjtë dhe të krishterët ndajnë një traditë biblike të përbashkëtpërsa i përket krijimit dhe ndonëse myslimanët mbështeten në burime të tjera shkrimore, përsëri të treja religjionet mund të konfirmojmë së bashku njëgamë të gjerë vlerash që lidhen me botën e krijuar. Në pjesën e parë të kësaj eseje do të përcaktoj dhe sqaroj gjashtë parimet kryesore të qasjes judeo-krishtere ndaj natyrës. Në pjesën e dytë, do të shpjegoj disa prej fushave problematike dhe më pas do të jap disa këshilla për tu përdorur përmësim dhe predikim.

Gjashtë parimet

Parimi i parë: Krijimi është i mirë; ai reflekton madhështinë e Krijuesit të tij. “Atëherë Perëndia shikoi të gjitha ato që kishte bërë, dhe ja, ishte shumëmirë.”. Judaizmi konfirmon jetën, jo vetëm jetën njerëzore, por edhe biosferën në tërësi.

A janë Judazmi, Krishtërimi apo Islami biocentrikë? Sigurisht që jo. Besimi nuk fokusohet tek *bios*-i, por tek Zoti. Ne jemi tocentrikë dhe jo biocentrikë. Të fokusoshesh tek cdokush tjetër përveç Zotit përbën idhujtari. Natyra mbart ‘firmën’ e Perëndisë, ajo pasqyron madhështinë e Tij, kështu që të *barazosh* Zotin me natyrën është panteizëm. Prandaj ne e mohojmë Spinozën, deizmin dhe *dues sive natura*; është kjo arsyeja përse ne refuzojmë ligjërimet e shkujdesura të *gaia*-s si një “perëndeshë e tokës”, një hyjni më vete; ka vetëm një Zot dhe vetëm Ai mund të urdhërojë.

Rabini Abraham Isak Kook (1865-1935), mbështetur në burime hebraike, duke nisur nga psalmet e deri tek misticizmi Lurianik, e ka kuptuar në mënyrë të mrekullueshme domethënien hyjnore të gjithçkaje: “Më kujtohet që me hirin e Perëndisë në vitin 5665 [1904-1905] vizitova Jafën qëndodhet në tokën e shenjtë dhe shkova t’i tregoj respektin tim kryerabinit të qytetit [Rabini Kook]. Ai më priti ngrohtësisht... dhe pas faljes së drekësunë e shoqërova atë teksa ai, sic e kishte zakon, dilte për në fusha për të përqëndruar mendimet e tij. Ndësa po ecnim unë këputa disa lule ose bimë; ai u drohdhe me qetësi më tha se ai kujdesej gjithnjë shumë që të mos shkulte, vec nëse ishte e nevojshme, asnjë bimë që rritej... Cdo gjë që rritet thotë dicka, cdo gurë përshpërit ndonjë sekret, i gjithë krijimikëndon” [3]

Kook-i dëgjonte himnin që natyra i këndonte Zotit. Ai këndoi jo *në lëvdatë të* natyrës, por me natyrën në lavdërim të Zotit, në përputhje me psalme të tilla si psalmi 104 dhe 148.

Parimi i dytë: Biodiversiteti, shumëllojshmëria e pasur e natyrës, duhet ruajtur. Libri i Zanafillës përshkruan se si gjithçka ishte krijuar “sipas llojit të saj”; më pas Adami emërtoi cdo kafshë. Noe ruajti në arkën e tij një popullatë të përbërë nga një mashkull dhe një femër të aftë për t’u riprodhuar prej çdo specieje. [4]

Një seri e urdhërimesh biblike theksojnë dallueshmërinë e specieve. Në ditët tona, ne duhet ta lexojmë listën dietike [5], ligjet që ndalojnë përzjerjen e kullerave [6], si të leshit me lirin [7], ndalimin e hibridizimit apo bashkimit të kafshëve të ndryshme [8] si vërtetim i detyrës religjioze për ruajtjen e biodiversitetit.

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi